



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-012

Prishtinë, më 7 prill 2011, në orën 14:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 7 PRILL 2011

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Petar Miletqi dhe Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga Grupet Parlamentare: Adem Grabovci, Ibrahim Makolli, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Sasha Rashiq dhe Rasim Demiri.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Eshref Vishi, Ismet Hajrullahu dhe Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca;

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës.

Kryesia, me propozim të kryetarit, miratoi këtë:

R e n d d i t e

1. Shqyrtimin e kërkesës së Grupit të deputetëve të Kuvendit për mbledhje të jashtëzakonshme, më 7 prill 2011

Kryetari i njoftoi nënkryetarët e Kuvendit dhe kryetarët e grupeve parlamentare me përmbajtjen e kërkesës së Grupit prej 40 deputetëve të Kuvendit, që kishin parashtruar kërkesë për mbajtjen e mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit, më 7 prill 2011, në orën 18:00, me këtë rend dite:

1. Zgjedhja e Presidentit të Republikës së Kosovës dhe
2. Rezoluta në mbështetje të Memorandumit të Marrëveshjes ndërmjet z. Behgjet Pacolli, z. Isa Mustafa dhe z. Hashim Thaçi, të nënshkruar më 6 prill 2011.

Kryetari tha se kërkesa e cekur më lart është në përputhje me rregullat procedurale për punën e Kuvendit dhe hapi diskutimin lidhur me të.

Lidhur me kërkesën e grupit prej 40 deputetëve të Kuvendit për mbajtjen e mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit, diskutuan: Glauk Konjufca, Adem Grabovci, Ardian Gjini, Ibrahim Makolli dhe Visar Ymeri. Diskutimet e plota janë dhënë në Transkript.

Kryesia, njëzëri vendosi që mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të mbahet më 7 prill 2011, në orën 18:00, me këtë:

R e n d d i t e

1. Zgjedhja e Presidentit të Republikës së Kosovës,
2. Rezoluta në mbështetje të Memorandumit të Marrëveshjes ndërmjet z. Behgjet Pacolli, z. Isa Mustafa dhe z. Hashim Thaçi, të nënshkruar më 6 prill 2011.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 14:30 minuta.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Hartoi: Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale